

BASHKIA TEPELENË
NJOFTIM PË DHËNIEN ME QIRA

Në zbatim të VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar; Udhëzim Nr. 13, datë 26.4.2018 “Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; VKB nr.41 datë 29.03.2023 “Për miratimin e listës me sipërfaqet e trojeve për t’u dhënë me qira, ndodhur në Bashkinë Tepelenë” të sipërfaqes me numër pasurie 1061/5 ZK 2807, sipas certifikatës së pasurisë me kod unik 2807007038 në pronësi/përdorim të Bashkisë Tepelenë, ndodhur në Njësinë Administrative Kurvelesh, Bashkia Tepelenë:

NJOFTIM:

- Fillimin e procedurave të dhënies me qira të llojit “Truall” me numër pasurie 1061/5 ZK 2807 me sipërfaqe 200 m², ndodhur në Njësinë Administrative Kurvelesh/ Bashkia Tepelenë.
- Çmimi dysheme do të jetë në zbatim të VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, duke filluar nga 12 (dymbëdhjet) lekë/m²/muaj .
- Afati i kontratës së qirasë është deri në 10 vjet.
- Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikave:
 - Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet i cili përmban hartën treguese me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin pdf. dhe format elektronik në shkallë 1:2500 ku janë evidentuar elemente kryesore si: kufijtë natyrorë, relieve, objekte aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave..... 30 pikë.
 - Plani i biznesit dhe investimet.....20 pikë.
 - Niveli i punësimit.....10 pikë.
 - Masa e qirasë në vit.....40 pikë.
- Tërheqja e dokumentacionit të nevojshëm do të bëhet pranë Bashkisë Tepelenë.
- Paraqitja e dokumentacionit do të bëhet në datën 20.09.2024 ora 10:00 në zyrën e protokollit të Bashkisë Tepelenë dhe konkurimi do të vijojë në sallën e mbledhjeve.
- Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim është:
 - a) Kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.
 - b) NUIS/NIPT dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
 - c) Projektin teknik të hartuar nga specialist të licencuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit.
 - d) Planbiznesin e hollësishëm , ku të përshkruhen qartë:
 - i) plani i punësimit, ndikimi i tij në rritjen e të punësuarve.
 - ii) plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen.
 - iii) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin, makineri që zotëron.

- iv) Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 (pesë) vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 (pesë) vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër.
- e) Ofertën e detyrimit mujor të qirasë.
- f) Certifikatën e regjistrimit dhe ekstraktin historik të regjistrimit në QKB të subjektit.
- g) Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore.
- h) Vërtetim për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.
- a) Leje mjedisore për aktivitetin e kërkuar, (raport i ndikimit në mjedis i hartuar nga inxhinier mjedisi/studio mjedisore me licencë).
- b) Vërtetimin nga sektori i tatimeve Bashkia Tepelenë se subjekti nuk ka detyrime tatimore.
- c) Garanci të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në planbiznesin e dorëzuar (vërtetim nga banka).
- d) Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.
- e) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për shkualifikim.